



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "FAN S. NOLI", KORÇË
DREJTORIA E KURRIKULËS DHE VLERËSIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I KURRIKULËS VLERËSIMIT INSTITUCIONAL DHE ALUMNI

Korçë, më 20 / 01 / 2021


Nr 129 Prot

RAPORT I PYETËSORIT PËR MËSIMIN ONLINE DHJETOR-JANAR

Në kuadër të mbarëvajtjes së procesit të mësimit nëpërmjet platformave "ONLINE" Sektori i Kurrikulave, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, ka përgatitur pyetësorin elektronik për mësimin ONLINE, link-u i të cilit iu dërgua të gjithë studentëve në adresat zyrtare e për të nxjerrë problematikat dhe ecurinë e mësimit online në kuadër të cilësisë së mësimdhënies.


Pyetja 1

Pyetësori u plotësua nga 455 studentë për një kohë mesatare plotësimi prej 7 minuta. Nga totali i pyetësorëve të plotësuar, 184 studentë ishin nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, 128 nga Fakulteti i Ekonomisë, 123 nga Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë dhe 20 nga Fakulteti i Bujqësisë.



Pyetja 2 dhe 3

Për sa i përket ciklit të studimit 60 studentë ndjekin programe 2-vjecare profesionale, 314 bachelor dhe 81 master, përkatësisht 241 në vit të parë, 86 në vit të dytë, 128 në vit të tretë.



Pyetja 4

Numri i studentëve pjesëmarrës sipas programit të studimit

66 Bachelor në "Infermier i Përgjithshëm"	6 Program profesional 2- vjeçar "Edukim për Foshnjërinë dhe Fëmijërinë e Hershme"
48 Bachelor në "Financë-Kontabilitet"	5 Bachelor në "Administrim Biznesi në Turizëm"
26 Bachelor në "Gjuhë-Angleze"	5 Bachelor në "Matematikë-Fizikë"
26 Bachelor në "Mami"	5 Bachelor në "Teknologji Informacioni"
23 Bachelor në "Menaxhim"	3 Bachelor në "Histori-Gjeografi"
21 Program profesional 2- vjeçar "Asistent Menaxher"	3 Bachelor në "Inxhinieri Agronomike"
17 Bachelor në "Biologji-Kimi"	3 Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Biznesi Bujqësor"
16 Bachelor në "Mësuesi për Arsimin Fillor"	2 Bachelor në "Informatikë Biznesi"
16 Master Profesional në "Mësues i Gjuhës Angleze"	2 Bachelor në "Biznes dhe Tregti"
13 Bachelor në "Matematikë-Informatikë"	2 Master Profesional në "Mësues në Matematikë"
13 Program profesional 2- vjeçar "Shërbim Social"	2 Master Profesional në "Mësues në Shkenca Sociale"
12 Master Profesional në "Mësues për Arsimin Fillor"	2 Program profesional 2- vjeçar "Mbështetës Zyre për Komunikim Bibliotekë dhe Arkiv"
12 Master Profesional në "Mësues në Biologji-Kimi"	1 Bachelor në "Agroushqim"
12 Program profesional 2- vjeçar "Menaxhim Veterinar"	1 Master i Shkencave në "Filozofi Sociale"
10 Bachelor në "Edukim Fizik dhe Sporte"	1 Master i Shkencave në "Kulturë Media Editim"
10 Master Profesional në "Mësues në Histori-Gjeografi"	1 Master Profesional në "Bankë dhe Sigurime"
9 Bachelor në "Administrim Biznesi në Marketing"	1 Master Profesional në "Financë-Kontabilitet"
8 Bachelor në "Administrim Politika Sociale"	1 Master Profesional në "Sistemet Moderne të Telekomunikacionit dhe Teknologjitë e Internetit"
8 Bachelor në "Ekonomiks"	1 Master Profesional në "Turizëm"
8 Master Profesional në "Mësues për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi"	1 Master Profesional në "Administrim Publik"
7 Bachelor në "Gjuhë-Letërsi"	
7 Master Profesional në "Infermieristikë"	
6 Master i Shkencave në "Financë"	

Pyetja 5

Pothuajse 100% e studentëve pjesëmarrës janë përgjigjur që janë bërë tashmë pjesë e platformës për mësimin online Teams (Microsoft Office 365).

Pyetja 6

Vështirësitë dhe probleme të hasura në zbatimin e platformës online:

-40% e studentëve pjesëmarrës janë shprehur se nuk kanë pasur asnjë problematikë me përdorimin e platformës ose mësimin online në përgjithësi.

-24% janë shprehur se kanë pasur problem me internetin dhe rrjetin si: shpërndarje apo pamundësi për të pasur akses në internet për një kohë të gjatë ose dhe nuk kanë fare

mundësi për internet. Kjo është problematika me përqindjen më të lartë.

-8% e tyre kanë nxjerrë si problematikë **funksionimin e platformës**, kanë pasur vështirësi në mësimin si ta përdorin, paqartësi të ndryshme ose për mënyrën si funksionon sidomos në fillim dhe probleme me hyrjen në platformë.

-6% e pjesëmarrësve kanë cilësuar si problematikë **bllokimin e platformës** si pasojë e mbingarkesës ose e rrjetit.

5% kanë përmendur **shkëputjen e zërit** si një ndër problematikat, ose mosdëgjimin e saktë gjë që ka sjellë vështirësi në komunikim dhe ndërveprim.

-4.5% **vështirësi në kuptimin e leksioneve**, në kuptimin e shpjegimit, vështirësi në komunikim, teoria është disi me e kuptueshme por forma praktike dhe ushtrimet janë problem serioz.

-4% shprehen se është bërë shqetësuese nxjerrja e paautorizuar nga takimi dhe mbyllja e mikrofona, nga studentë të tjerë jo seriozë.

(Kjo problematikë është zgjidhur tashmë)

-3.5% mendojnë se nuk është njëlloj si mësimi në auditor ka vështirësi në tërësi dhe sidomos në lëndët që kanë nevojë për punë praktike, bëhen shumë pak ushtrime, mungon bashkëbisedimi, informacionet jepen në formë të shkurtuar, nevojitet më shumë zbatim dhe praktikë.

-3 % kanë cilësuar probleme të tjera të përmendura vetëm 1-2 herë secila, si më poshtë:

-Njoftimet për fillimin e mësimin nuk dërgohen të rregullta.

-Mungesa e mësimin pavarësisht njoftimit ose ndryshimi i orarit nga vetë pedagogët.

-Lodhje psikologjike, orar i zgjatur në kompjuter, lodhje e syve, mungesë përqendrimit.


-Shqetësim se si do të bëhet vlerësimi përfundimtar.

-Nëse e njëjta lëndë bëhet me orë të zgjatura bëhet e mërzitshme.

-Marrja e mungesave.

-Emërtimi i grupeve nga pedagogët.

-2% përmendin si vështirësi dërgimin e detyrave ose marrjen e materialeve.



Pyetja 7

Zhvillimi i mësimin

26% e studentëve janë shprehur se ka pasur raste kur mësimi nuk është zhvilluar rregullisht kundrejt një përqindjeje prej 74% ku është cilësuar se **mësimi është zhvilluar rregullisht**.

-Kjo përqindje tregon **angazhimin e dyanshëm** edhe të pedagogëve edhe të studentëve në procesin mësimor, duke shfrytëzuar mundësinë e mësimi online nëpërmjet platformës.

-Studentët, të cilët janë shprehur se nuk është zhvilluar mësimi, disa i janë referuar edhe mos angazhimit të tyre personal për arsye të ndryshme, disa prej të cilave janë listuar më poshtë, që do të thotë se mësimi është zhvilluar, por studentët nuk kanë pasur mundësi të marrin pjesë.

Pyetja 8

Arsyet në rast moszhvillimi të mësimi

Nga 26% e studentëve të cilët janë shprehur se **mësimi nuk është zhvilluar rregullisht 10% nuk kanë dhënë një arsye përse** ose janë shprehur se nuk e dinë arsyen, ndërsa **16% kanë listuar arsyet** që sipas studentëve janë:

-8% listojnë si arsye **mungesën e internetit** dhe mosfunksionimin e platformës.

-2% përmendin **përplasje oraresh** për shkak të ndryshimeve nga pedagogët.

-1% leksionet vetëm dërgohen nuk shpjegohen.

-1% probleme shëndetësore të pedagogut.

-1.5% angazhime të tjera të pedagogëve por disa njoftojnë që mësimi do të realizohet në një moment të dytë.

-1% angazhime të tjera të studentëve gjatë orarit mësimor.

-0.5% problem me pedagogët e jashtëm.

-0.5% problem me lëndët praktike.

-0.5% kanë cilësuar arsye të tjera të përmendura vetëm 1 herë secila:

-Nuk janë bërë pjesë e grupeve nga pedagogët.

-Nuk është zhvilluar lënda “Kontroll Ushqimor”.

-Nuk është zhvilluar lënda “Kontrolli i Produkteve Shtazore”.

Pyetja 9

Për sa i përket **vlerësimit** të procesit online nga 1 deri në 5, ku 1 tregon pikën më të dobët dhe 5 pikën më të fortë, vlerësimi total ka qenë në një nivel mbi mesatar prej **3.23** gjë e cila tregon një **rritje të vlerësimit** në krahasim me rezultatet paraprake të mara në fazën e parë. Çka do të thotë se disa prej problemeve janë zgjidhur, mësimi online dhe platforma po funksionojnë edhe më mirë.

Shprehur në përqindje:


23% kanë dhënë vlerësimin 5

20% kanë dhënë vlerësimin 4

28% kanë dhënë vlerësimin 3

16.5% kanë dhënë vlerësimin 2

12.5% kanë dhënë vlerësimin 1



Pyetja 10

68% e pjesëmarrësve nuk kanë dhënë asnjë përgjigje ose e kanë cilësuar me shkrim që nuk kanë asnjë mendim apo sugjerim.

32% e tyre kanë dhënë **mendime dhe sugjerime.**

Mendimet

1% e studentëve janë shprehur se në pamundësi të mësimi në auditore, zgjidhja e mësimi online është një mundësi e mirë dhe mësimi të vazhdojë online për të shmangur problemet shëndetësore në varësi të situatës.

1 % kanë dhënë disa mendime si:

- Mësimi online nuk është 100% efektiv, ka vështirësi me zgjidhjen e ushtrimeve, studentët janë të shqetësuar për provimet dhe nëse kanë marrë mjaftueshëm informacion deri tani.
- Po ashtu ata janë shprehur se mësimi online ka pasur përmirësim në krahasim me fazën e parë por përsëri vërehet mungesë interaktiviteti dhe mbingarkesë.
- Shqetësim tjetër është mungesa ekonomike që sipas tyre sjell edhe mungesë të internetit.

Sugjerimet

20% e studentëve kërkojnë të **kthehen në auditore** sa më shpejt që të jetë e mundur.

7% shprehen se një zgjidhje është edhe **mësimi i alternuar**, të paktën seminarët të zhvillohen në auditor ose të paktën lëndët që kanë punë praktike dhe me ushtrime të zhvillohen në auditor dhe leksionet ose teoria online.

2% japin sugjerime të ndryshme si:

- Të ketë më tepër vëmendje për studentët me ndihmë ekonomike ose probleme të ngjashme.
- Të mundësohet një infrastrukturë e përshtatshme për studentët ekselentë dhe për ata me ndihmë ekonomike ose të mundësohen pajisje si laptop apo tablet.
- Të zhvillohet lënda "Kontrolli i Produkteve Shtazore" dhe të jepet sa më shpejt një zgjidhje si do të veprohet.
- Nevojitet më shumë praktikë dhe mësimi online po e pengon këtë fakt.
- Të mundësohet një bibliotekë online në gjuhën shqipe.
- Orët të mos zgjaten shumë sepse shkaktohet lodhje mendore.
- Të ketë korrektësi në oraret mësimore.

1% kërkojnë **zgjidhje për provimet.**

PËRFUNDIME

Qëllimi i zhvillimit të këtij pyetësoi i trajtuar që në hyrje të tij synon nxjerrjen e problemeve gjatë mësimi online në mënyrë që të merren masat për përmirësim nga njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

1. Pyetësoi i muajit nëntor¹ shërbeu për zgjidhjen e problemeve në fillimet e mësimi online dhe nga përgjigjet e pyetësorit të muajit janar vihet re se problematikat e hasura në muajin nëntor janë zgjidhur nga drejtuesit e njësive kryesore dhe bazë.

2. Nga përgjigjet e mara rezultoi se mësimi online është zhvilluar rregullisht në një përqindje të kënaqshme, është pozitiv fakti që: pothuajse 100% e studentëve

¹ I cili përfshin të njëjtat pyetje me pyetësorin e muajit janar.

pjesëmarrës janë përgjigjur që janë bërë tashmë pjesë e platformës për mësimin online Teams (Microsoft Office 365).

3. Fakti që 40% e studentëve pjesëmarrës janë shprehur se nuk kanë pasur asnjë problematikë me përdorimin e platformës dhe vlerësimi i përgjithshëm është rritur në nivel mbi mesatar është tregues pozitiv për sa i përket angazhimit të pedagogëve, studentëve dhe të njëjsteve bazë për zgjidhjen e problematikave apo përmirësimet mundshme.

4. Problematika kryesore që studentët kanë shprehur është interneti dhe rrjeti me probleme si: shpëputje apo pamundësi për të pasur akses në internet për një kohë të gjatë ose dhe nuk kanë fare mundësi për internet.

5. Ndërsa sugjerimi kryesor është kthimi në auditor sa më shpejt që të jetë e mundur ose mësimi i alternuar ku seminarët ose orët praktike të zhvillohen në grupe të vogla në auditor.

6. Nëse do të bënim një krahasim të shkurtër me përfundimet e pyetësorit të muajit nëntor problematikat kryesore me njohjen dhe hyrjen në platformë dhe organizimin e grupeve dhe mësimi pothuajse janë zgjidhur tërësisht. Po ashtu nga 35% e studentëve të përgjigjur në fazën e parë se në disa prej lëndëve nuk ishte zhvilluar mësim kjo është reduktuar në një numër shumë të vogël.

SUGJERIME

Pavarësisht sa më sipër, ka ende vend për përmirësim dhe ende punë që të zgjidhen problematikat e listuara apo të merren parasysh sugjerimet e studentëve. Disa prej sugjerimeve duke u mbështetur edhe në ato të studentëve janë:

1. *Lidhur me lëndët e pazhvilluara të përmendura nga studentët (që në krahasim me muajin nëntor janë përmendur shumë më pak) sugjerohet të verifikohen nga njësitë bazë në mënyrë që mësimi të realizohet i plotë.*
2. *Lidhur me zhvillimin e mësimin online nga pedagogët e jashtëm për shkak se këta të fundit nuk kanë akses në platformën OFFICE 365, mësimin mund ta zhvillojnë nëpërmjet platformave të tjera (G-Classroom, G-Meet etj.), këshillohen njësitë bazë të bëjnë verifikimet përkatëse nëse po zhvillohet mësim me platformat e tjera nga këta pedagogë.*
3. *Si model efektiv sugjerohet shtimi i laboratorëve me pajisje për mësim online në mënyrë që studentët të ndihen si pjesë e auditorit dhe të përvetësojnë më lehtë sidomos lëndët që kërkojnë shpjegim konkret në tabelë dhe tu kushtohet më shumë rëndësi lëndëve që kërkojnë më shumë praktikë, apo që kanë më shumë ushtrime, të gjenden zgjidhje alternative për to, po ashtu edhe për dërgimin e detyrave ose marrjen e materialeve.*
4. *Pedagogët të kujdesen të mos ndryshohen oraret e zhvillimit të mësimin pasi shkaktojnë probleme me funksionimin e platformës ose me njoftimin e studentëve.*
5. *Të merren masa paraprake për zhvillimin e provimeve dhe të njoftohen studentët sa më parë për të shmangur shqetësimin që ju është krijuar.*
6. *Të mendohet nëse ka zgjidhje teknike çështja për funksionimin dhe bllokimin e platformës si pasojë e mbingarkesës.*
7. *Të nxitën dhe të këshillohen studentët që të angazhohen sa më shumë të jetë e mundur për të zvogëluar hapësirën që krijohet nga mësimi online.*

Spektori i Kurrikulës Vlerësimi Institucional dhe Alurni

Evis Kapurani

